



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo
01Nr.111-31897/13
Kaçanik;20.01.2014



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

SHPALLJE E REKRUTIMIT

Komuna e Kaçanikut, në mbështetje të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, shpallë konkursin për plotësimin e vendit të lirë të punës:

TITULLI I VENDIT TË PUNËS:

I. NËPUNËS I SHËRBIMEVE SOCIALE

Drejtoria: Drejtoria e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale –

Njësia –Qendra për punë sociale

Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës: koeficienti 6.5

Numri i referencës së vendit të punës: 111-31897/13

Detyrat dhe përgjegjësitë

- 1.Të bëjë mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror, birësimin, strehimin familjar, kujdestarinë, strehimin e përkohshëm familjar.
- 2.Të shqyrtoj rastet e abuzimit dhe të lënjes pas dore të fëmijëve dhe të merren masa të duhura
3. Të bëjë mbrojtjen e fëmijëve me sjellje asociale dhe delikuate
- 4.Të punojë në sanimin e mardhënieve të çrregulluara bashkëshortore dhe familjare
5. Bënë propozimin e besimit të fëmijëve në raste të shkurorëzimit të prindërve dhe përcjell realizimin e kontakteve
6. Përcjellë rastet e dhunës në familje dhe rastet e trafikimit
- 7.Bënë mbrojtjen e të moshuarëve dhe jep propozime lidhur me to
- 8.Kryen punë dhe detyra tjera të punës sipas nevojave të QPS-ës dhe legjislacionit në fuqi.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

- Në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative dhe të cilat kanë aftësi fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.

Procedurat e konkurimit: Procedura e konkurimit është e hapur për të gjithë kandidatët e jashtëm si dhe nëpunësit civil ekzistues.

Shkollimi i kërkuar, Aftësitë, përvoja dhe attribute tjera që kërkohen:

- Përgatitje universitare në shkenca shoqërore.
- Të kenë më së paku tri vjet përvojë pune
- Aftësi për të qenë fleksibil dhe për punë në ekip
- Gatishmëri për tu shërbyer palëve dhe për të punuar edhe jashtë orarit të rregullt të punës
- Njohuri të mira në aplikimin e programeve Microsoft office (Excel, Word, Power point)

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Përzgjedhja bëhet duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kohëzgjatja e emërimit : Sipas legjislacionit në fuqi.

Data e mbylljes së konkursit; Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik.

Paraqitja e kërkesave: Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në shërbimin e shkrimores **-Zyra e pranimit**, kati përdhësë dhe në web-faqen komunale .

Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten këto dokumente: Diplomën e Fakultetit të kryer apo Kopjen e vërtetuar të Diplomës, Dëshmi për përvojen e punës, kopjen e letërnjoftimit, certifikatën e lindjes, certifikata mbi trajnimet e kryera, Çertifikatën shëndetësore me të cilën dëshmohet gjendja shëndetësore.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e ngushtë do të kontaktohen. Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë zyrën e personelit

Kryetari i Komunës
z.Besim Ilazi